



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MAT

NJËSIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

**SHPLLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË
KATEGORINË E ULËT DREJTUESE,
LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË**

PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË INFRASTRUKTURËS, BASHKIA MAT
Niveli i diplomës: Master Shkencor në Shkenca Juridike, Ekonomike dhe Inxhinieri
(Ndërtimi, Mekanike)

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë Mat shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturrës, Bashkia Mat,
Kategoria e pagës III-a/1

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

**Afati për dorëzimin e dokumenteve për
LËVIZJE PARALELE:**

20 shtator 2021

**Afati për dorëzimin e dokumenteve për
NGRITJE NË DETYRË:**

27 shtator 2021

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Organizon, koordinon dhe drejton punën brenda Sektorit duke bërë ndarjen e detyrave për punonjësit e Sektorit si dhe duke mbikëqyrur dhe duke siguruar kryerjen në kohë dhe me cilësi të detyrave nga ana e këtyre punonjësve;
2. Organizon punën për të siguruar mbledhjen e informacionit, matjet e trafikut, analizimin dhe evidentimin e problematikës ekzistuese mbi situatën e qarkullimit të njerëzve dhe mallrave, gjendjes fizike të rrjetit rrugor dhe sinjalistikës;
3. Harton studimet dhe projektimet dhe parashikon kostot e shenjave të trafikut, shenjëzimeve vertikale, horizontale, impianteve të semaforëve dhe mënyrën e mirëmbajtjes së tyre, ashtu si dhe impianteve të tjera teknologjike të destinuar për disiplinimin dhe sigurinë e trafikut;
4. Siguron realizimin e investimeve publike në kohë dhe me cilësi për objektet e infrastrukturës si dhe realizimin e tyre në afatet e përcaktuara, konform kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit sipas projekteve të miratuara, nëpërmjet monitorimit rigoroz dhe të vazhdueshëm;
5. Zbaton politikat dhe strategjitë që lidhen me rrjetet e ujësjellës-kanalizimeve, rrjeteve telefonike si dhe rrjeteve elektrike si dhe administrimin sa më optimal të dokumentacionit teknik për rrjetet e mësipërme.
6. Përgatit dhe propozon rekomandime për përmirësimin e shërbimit, ristrukturimit të ndërmarrjeve apo vlerësimit të mundësive të tjera duke vlerësuar partneritetin publik-privat;
7. Monitoron në terren investimet, rehabilitimet, riparimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimet e mirëmbajtjes, që realizohen nëpërmjet ndërmarrjeve të varësisë si dhe kur ato kanë nënshkruar kontrata të sipërmarrjes ose të shërbimit
8. Zhvillon dhe përmirëson teknologjinë e trajtimit të mbetjeve urbane dhe të ngurta, në përputhje me strategjitë kombëtare, duke synuar zbutjen e ndikimeve negative dhe mbrojtjen e mjedisit, me kosto sa më efektive për Bashkinë;
9. Harton projektet dhe preventivat e rikonstruksionit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes, që kryhet nga agjencitë dhe ndërmarrjet e shërbimeve Bashkiake, të të gjithë infrastrukturës së Bashkisë .
10. Kontrollon dhe miraton situacionet e punimeve dhe të konsumit të bazës materialo-teknike, të kryera dhe shpenzuara nga ana e ndërmarrjeve të vartësisë.
11. Të sigurojë përmes akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të saj, që i gjithë komuniteti të përfitojë shërbimin e ndriçimit publik sipas standardeve më të mira teknike dhe ekonomike.
12. Të adoptojë standarde teknike dhe ekonomike bashkëkohore në ofrimin e shërbimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit, shtrirjen e mbulimit në të gjitha zonat e banuara të territorit të bashkisë.
13. Të marrë masa konkrete për uljen e kostove për buxhetin e bashkisë dhe përmirësimin e efikasitetit energjetike në dhënien e këtij shërbimi nëpërmjet ri-kualifikimit të rrjetit apo sistemeve të ndriçimit rrugor nëpërmjet zëvendësimit të të gjithë pajisjeve të amortizuara apo adoptimit të sistemeve novatore që ulin konsumin dhe kostot e energjisë.
15. Të ndërmarrë iniciativa për vlerësimin periodik të efikasitetit dhe efikasitetit të shërbimit dhe të informojë komunitetin mbi rezultatet e këtyre vlerësimeve.
16. Të garantojë mundësinë e komunitetit, të marrë pjesë dhe të dëgjohet në lidhje me iniciativat që kanë për qëllim mbulimin e territorit, ndryshimin e administrimit apo ndërhyrjet teknike në rrjetet apo sistemet e ndriçimit publik.

17. Të ndihmojë në përmirësimin e sigurisë së komunitetit nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik në mënyrë të veçantë në zonat me indeks të lartë kriminaliteti.
18. Të mbrojë komunitetin nga ndotja optike (nga ndriçimi) që shkaktohet qoftë nga sistemi i ndriçimit publik qoftë nga sistemet e ndriçimit të instaluar nga privatët.
19. Të marrë në shqyrtim ankesat e qytetarëve në komunitetet urbane dhe lokale në lidhje me problemet me ndriçimin rrugor.
20. Të kryejë kontrollin dhe inspektimin në terren me ekipet përgjegjëse për mirëmbajtjen e ndriçimit publik dhe të identifikojë nevojat për ndërhyrje dhe riparime.
21. Të mandatojë riparime në defekte të vogla në ndriçimin publik.
22. Të mbajë evidencën e pajisjeve të çmontuara që mund të ripërdoren.
23. Të mbledhë dhe organizojë dokumentacionin sipas ndarjeve dhe nënndarjeve të zonave të ndriçimit.
24. Të kryejë edhe detyra të tjera që i ngarkohen nga eprori.

1

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (III-a/1);
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë sistem 4 – vjeçar apo Diplomë Master Shkencor në në fushën Juridike, Ekonomike dhe Inxhinieri (Ndërtim, Mekanike). Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. *(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehtsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b- Të zotërojnë dëshminë e audituesit të çertifikuar.
- c- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet.
- d- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

1.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

1.3

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 22.09.2021, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Bashkinë Mat do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Mat (nëse është e mundur teknikisht) dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, Ligji 139/2015 i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Njohuri në lidhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
- Ligji nr.8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar;
- VKM-në nr.354 date 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim ,mbikëqyrje dhe kolaudim”;
- Udhëzim nr.3 date 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar;
- Vendimin nr. 68, date 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit , i ndryshuar me VKM-ne nr. 186. date 3.5.2002;
- Udhëzimin nr. 2 date 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Mat (nëse do të jetë e mundur teknikisht) dhe standat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2 NGRITJA NË DETYRË

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Bashkisë Mat dhe standat e informimit të publikut duke filluar nga data 22.09.2021.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-a/1;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master shkencor”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të zotërojnë një diplomë sistem 4 – vjeçar apo Diplomë Master Shkencor në fushën Juridike, Ekonomike dhe Inxhinieri (Ndërtim, Mekanike).. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b- Të zotërojnë dëshminë e audituesit të certifikuar.
- c- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet.
- d- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a- Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet për konkurrim, të listuara në piken 1.2.
- b- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë Mat brenda datës 27.09.2021.

Në datën 06.10.2021, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë (nëse është e mundur teknikisht) dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e mos kualifikimit.

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Mat, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.